



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



E K S T R A K T

i procesverbalit të mbledhjes së dytë të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, mbajtur më 5.6.2023, duke filluar nga ora 16:00.

Në mbledhje morën pjesë: Fiknete Bejta LDK, kryesuese, Taulant Maxharra -AAK, Liridon Selmani PDK, Mimoza Xhaka- Bllacaku dhe Radie Hoxhaj LVV.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoit **Fiknete Bejta**, kryesuese e komitetit dhe propozoi këtë

Rend të ditës

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
2. Informatë nga Drejtoria e Mirëqenies Sociale;
3. Informatë nga Drejtoria e Shëndetësisë;
4. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Kryesuesja konstatai se njëzéri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Pika e dytë

Informatë nga Drejtoria e Mirëqenies Sociale.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Adelina Sahiti, drejtore tha se është hera e dytë që po e bëjmë një informim për punët e mira që po i bëjmë në kryeqytet dhe normalisht më gjëzon fakti që sot para juve mund të dal me gjëra të mira që po bëjmë për banorët e kryeqytetit. Fillimisht ceku se me hapa të shpejtë jemi duke e rinovuar Shoqatën Qendrore të Personave të Shurdhër në Kryeqytet, po ashtu kemi filluar punët te banja e të moshuarve në Istog, ku janë

Faqe 1 nga 3

cenueshëm. Pretendimi ynë është ta bëjmë një fshat social në kryeqytet, në zemër të Prishtinës, ku aty do të zhvendoset edhe Drejtoria e Mirëqenies Sociale.

Tani veq jemi në fazat e buxhetimit, e që normalisht na duhet edhe lobimi juaj si komitet, që të shtohen financat në Drejtorinë e Mirëqenies Sociale, kështu që ne si drejtori mundohemi t'i shtyjmë proceset tonë përpara, çdo herë në dobi të qytetarëve të Prishtinës.

Liridon Selmani kërkoi të dijë se me çfarë kritere do t'i shpërndani mjetet e subvacioneve, si i keni paraparë, në çfarë fusha do t'i ndani, sa është buxheti dhe kush do ta përbëjë atë komision.

Mimoza Xhaka, kërkoi të dijë se a keni paraparë ndonjë përcaktim të numrit të kategorive, duke e ditur nevojën kaq të madhe dhe a bazoheni në këtë buxhetin që e ka drejtoria e juaj. Po ashtu qendra që parashihet të ndërtohet, a do të jetë me qëndrim dhe cilën kategori e keni futur në prioritet.

Fikneta Bejta, kryesuese tha se, me çfarë kohe është plani dinamik të realizohet ky projekt për ndërtimin e kësaj qendre.

Radie Hoxhaj tha se do të ishte mirë që dy hapësira të cilat janë pronë e Komunës së Prishtinës, në lagjen "Kodra e Diellit", a do të kishte mundësi që ato hapësira të lirohen, sepse ka shumë fëmijë me probleme sociale, nënat vetushqyese dalin me fëmijë e nuk kanë ku me i ruajtur e ku me i mbajtur ata fëmijë dhe me pasur qëndrim të natës në at objekt.

Lidhur me pyetjet dhe sugjerimet e dhëna nga anëtarët e komitetit, përgjigje dha Adelina Sahiti, drejtore.

Pika e tretë

Informatë nga Drejtoria e Shëndetësisë

Izet Sadiku, drejtor paraqiti një informatë nga Drejtoria e Shëndetësisë duke cekur se, sa u përket zhvillimeve në shëndetësi, ne i kemi disa plane ambicioze. Çështja e parë është infrastruktura shëndetësore në Kryeqytet, ku gjatë muajit qershor, ne do ta hapim Qendrën e Mjekësisë Familjare në Vëterrnik, ku do ti ketë të gjitha shërbimet. Po ashtu në aspektin infrastrukturor jemi duke e bërë edhe në "Bardhosh" dhe atje kemi vendosur një laborator dhe besoj së shpejti do ta kemi edhe Qendrën e Mjekësisë Familjare.

Gjithashtu në bazë të një analize që e kemi bërë, kemi vendosur që njëren prej punkteve të urgjencës me e vendosur në lagjen "Bregu i Diellit". Qyteti i ka katër punkte, punkti kryesor është tek "Rrethi me Flamur", pastaj në rruhen "Xhemail Ibishi", është në QKMF dhe në lagjen "Mahalla e Muhaxherëve". Nga "Mahalla e Muhaxherëve" deri në "Matiçan" apo në "Hajvali" e "Mramor" nuk kemi punkte të urgjencës.

Radie Hoxhaj dhe **Taulant Maxharaj** kërkuan të dijnë se në këto ambulanta a bëhen analizat, cilat prej analizave mund të bëhen. Po ashtu **Radie Hoxhaj** tha se pse nuk kemi shërbime fizioterapeutike. Gjithashtu ceku se sa i përket angazhimit të mjekëve nëpër këto ambulanta, do të ishte mirë që të bëhet edhe angazhimi i mjekëve pensionistë dhe të motrave medicinale, ku do të kryenin shumë punë pikërisht në këtë sektor, në dhënien e terapisë nëpër shtëpia.

Mimoza Xhaka tha se në këto ambulanta a ka shërbime gjinekologjike, pasi që këto janë të domosdoshme, sepse në repartin e gjinekologjisë të traumatizojnë.

Liridon Selmani tha se në lagjen "Lakërishte", konkretisht përballë stacionit të trenit, është kërkesë e asaj zonës që nëse ka mundësi të planifikohet ndërtimi i një qendre të mjekësisë familjare. Po ashtu kërkoi të dijë se është menduar të bëhet diçka me fëmijët me autizëm, pasi që kjo kategori e fëmijëve kan shumë nevojë për defektolog, logoped, psikolog, etj.

Pika e katërt Të ndryshme

Liridon Selmani ishte i mendimit që në njëren nga ditët në vijim, të gjithë anëtarët e komitetit ta bëjnë një vizitë në ndonjëren prej qendrave të mjekësisë familjare, që të njihemi më për se afërmë se si po reflektojnë pacientët, a po bëhen me të vërtetë analizat, a po ofrohen me të vërtetë këto shërbime.

Fikneta Bejta, kryesuese tha se plotësisht pajtohem me propozimin e z. Selmani dhe ne si komitet për këtë vizitë të koordino hemi brenda një kohe të shkurtër.

Mbledhja përfundoi në orën 16:45.

**Procesmbajtësi
Zijadin Gashi**

**Kryesuesja e komitetit
Fikneta Bejta**



Faqe 3 nga 3